



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna Klinë

Zyra e Kryetarit të Komunës

Nr. 06-33777/23

Klinë, datë: 25.10.2023

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me bujqit, fermerët, kultivuesit e tjerë të Klinës, i cili me Planin e organizimit të dëgjimeve buxhetore për vitin 2024, u planifikuar të mbahet në parkun “Ilir Merturi”, u mbajt në sallën e kuvendit të komunës me datë 10 gusht, në ora 18:00. Ndryshimi i vendit të mbajtjes së takimit është bërë për shkak të motit dhe mundësisë që të ketë reshje të shiut. Në këtë takim morën pjesë: 10 persona.

RENDI I DITES

1. DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS 2024 – 2026

Komuna e Klinës ka vazhduar me debatet me publikun me bujqit, fermerët, kultivuesit e tjerë të Klinës, i cili u mbajt në sallën e kuvendit komunal. Për pikën e rendit të ditës draft-plani i buxhetit komunal i Klinës 2024 – 2026, fjalën hyrëse e mori drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Lorenc Marleku, i cili ishte i shoqëruar nga përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Drejtori Marleku pasi përshëndeti të pranishmit, bëri një prezantim të përmbajtjes së draft-buxheti për vitin 2024 me theks të veçantë kategorinë subvencione dhe pasi që pjesëmarrësit ishin që të gjithë bujq, fermerë dhe kultivuesit e tjerë, ai informoi mbi investimet që janë realizuar brenda këtij viti me ndarje e një numri të madh të serave në dy faza të investimeve si dhe fidanëve.

~~Investimet e ardhshme sipas drejtorit Marleku do të fokusohen në furnizim me mekanizëm bujqësorë e që komuna e Klinës tashmë i ka në fazën e prokurimit publik e që janë: shkrirëse dylli, moto-kultivator, mbjellëse për grurë, mbjellëse për misër etj.~~

Pas drejtorit Marleku, përfaqësuesi i drejtorisë së Financave, z. Ajet Sejdiu, ju dha fjalën pjesëmarrësve për të diskutuar lidhur me atë që u prezantua nga ana e drejtorit si dhe ndarjen e nevojave dhe kërkesave apo edhe shprehjen e sugjerimeve që ata kanë lidhur me buxhetin e viti 2024.

DISKUTIMET DHE KËRKESART

Mehmet Mehmetaj – Fermerë nga fshati Gllarevë, përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe nga drejtori i Bujqësisë kërkoi të rriten shumat e buxhetit sa i përket investimeve në bujqësi në mënyrë që bujqit, fermerët, kultivuesit e tjerë të Klinës, të përfitojnë më shumë pasi që Klina ka tokë të mirë bujqësore si dhe kushte të zhvillohen e kultivohen shumë kultura. Sipas tij duhet të merren shembuj komunat përreth sa i përket investimeve aq të mëdha që i orientojnë në bujqësi.

Anton Lleshi – Fermerë nga fshati Jagodë, përshëndeti të pranishmit dhe parashtroi disa sugjerime rreth aplikimeve të kritereve për ndarjen e subvencioneve në formë të pajisjeve nga komuna e Klinës, e cila po bëhet duke përkrahur më shumë fermerët e vegjël se sa fermerët e mëdhenj. Potenco faktin që nuk qëndron kundër kësaj mirëpo duhet të mendohet edhe ndarja e subvencioneve në formë të mekanizmave të mëdhenj të cilët ju ndihmojnë shumë fermerëve që kanë sipërfaqe të mëdha të mbjellave. Ai gjithashtu kërkoi nga drejtori Marleku që projektet të cilat po realizohen në territorin e komunës së Klinës në kuadër të bujqësisë të ketë për to kontroll dhe vizita më të shpeshta e më të rrepta në teren në mënyrë që ndërtimi i tyre të bëhet më i fort dhe më i qëndrueshëm.



Petrir Nrecaj – Fermerë nga fshati Krushevë e Madhe, parashtroi para drejtorit nevojën dhe sugjerimin që ti kushtohet rendësi e veçantë ndërtimit të kanaleve të ujitjeve të cilat janë në projekte tani ose atyre që do të ndërtohen me vonë. Të ketë synime që një kanal i ujitjes të ndërtohen në teren apo linja e tij të jetë shumë e shfrytëzueshme dhe të prekë shumë hapësira në mënyrë që sa më shumë banorë ta shfrytëzojnë. Teknikisht rrjedha e tij si projekt për ujitje të kaloj mundësisht në disa fshatra e të mos pushoj uji po të ketë rrjedhe më të fuqishme.

Keq Raci – Fermerë nga fshati Jelloc, kërkoi nga drejtori i Bujqësisë që vitin e ardhshëm apo në draft-planin e buxhetit komunal i Klinës 2024 – 2026, të parashihet ndarja e mekanizmave bujqësor mbjellëse e grurit.

Elmi Qupeva – Fermerë nga fshati Pogragjë, kërkoi nga drejtori i Bujqësisë dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore që si sugjerim ta shqyrtoj opsionin që vitin e ardhshëm të anashkalohet ndarja e serave, makinave mjelëse e makinave të vogëla po të shikohen mundësit që të investohet në mekanizëm të madh bujqësor siç janë mbjellëset e grurit apo mbjellëset e misrit, shpërndarëse të plehut, spërkatëse apo edhe rimorkio për transport.

Anton Nikollaj – Fermerë nga fshati Videjë, theksoi gjatë këtij takimi që drejtorja e Bujqësisë duhet të rris buxhetin dhe subvencionet pasi që Klina ka shumë fermerë të zot dhe kushtet për zhvillimin e bujqësisë apo të mbjellave janë tejet të favorshme.

Takimi përfundoi në orën 18:43.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	0
Meshkuj	10
Total:	10

Procesmbajtëse:

Vlora Tafili

Klinë, datë: 25.09.2024

